



Më datë 04.05.2022 Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Fier zhvilloi një fushatë ndërgjegjësimi pranë Qendrës Sociale Murialdo me nxënësit e kursit profesional " Mekanik dhe elektroaut" mbi ligjin 111/2017 kategoritë përfituese dhe sesi ata mund të pëfitonin avokat falas nëse gjenden në pozita në konflikt me ligjin por edhe në pozitën e viktimës së veprës penale.





Më datë 10.05.2022, Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Vlorë mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga Qendra për të Drejtat në Punë në bashkëpunim me Qendrën Rinore Vlorë, ku u prezantuan gjetjet e studimit kombëtar "Dhuna dhe Ngacmimet në Botën Shqiptare të Punës" dhe u diskutua mbi hapat e nevojshëm për tu ndërrmarrë për të eliminuar dhunën dhe ngacmimet në vendin e punës. Nga ana e Qendrës u bë e mundur informimi i pjesëmarrësve mbi shërbimin ligjor Falas dhe mbi shërbimet që ofron Qendra.



Më datë 11.05.2022 Qendra e Ndhmës Juridike Falas Fier zhvilloi një aktivitet në bashkëpunim me organizatën Romacted Albania në ambientet e qendrës kulturore në Bashkinë Roskovec, sesion informues mbi ligjin për ndihmë juridike të garantuar nga shteti dhe ndihmë për tu akesuar në shërbimet online duke demonstruar edhe me video projector. Gjatë takimit pati diskutime mbi problematika të ndryshme si dhe u ndihmua nga punonjësi i qendrës në regjistrimin dhe rikuperimin e portalit për të pranishmit.





Referuar mbylljes së sporteve fizike dhe problematikave të hasura nga qytetarët të cilët nuk kanë mundësinë apo njohuritë e duhura për tu aksesuar online ne portalin E-albania, Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Vlorë zhvilloi një takim pranë zyrave të Gjendjes Civile Vlorë për të bashkëpunuar dhe për të referuar rastet pranë Qendrës për ata qytetarë në pamundësi ekonomike apo kategori vulnerabël, me qellim asistencën për gjenerimin e dokumentave online nëpërmjet portalit E-Albania, duke shmangur në këtë mënyrë pagesat.

Më datë 17.05.2022 Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier ishte e ftuar në takimin e zhvilluar nga OMSA në kuadër të "Ditës ndërkombëtare kundër Homofonis" në bashkëpunim me qendrën Epoka dhe KMD në ambientet e qendrës kulturore Epoka Fier. Të ftuar ishin gjimnazistë dhe persona të komunitetit LGBTI Gjatë takimit pati diskutime mbi problematika të ndryshme.




18.05.2022 Qendra e Ndihmës Juridike Falas Fier ishte e ftuar në një seminar që u organizua për të prezantuar draft shtojcën e planit social për shërbimet shoqërore për personat me aftësi të kufizuara në Bashkinë Fier në bashkëpunim me FSHDPAK .



Më datë 19.05.2022 Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier zhvilloi një takim pranë Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Fier në kuadër të "Promovimit dhe aksesit në përfitimin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti" me drejtuesit dhe kursantet e grupeve të ndryshme që marrin njohuritë në këtë qender. Gjatë takimit pati pyetje dhe trajtime të rasteve konkrete nga të pranishmit.



Më datë 26.05.2022 Qendra e Shërbimit të Ndhimës Juridike Parësore Vlorë, zhvilloi një takim me Drejtuesin e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Vlorë në kuadër të bashkëpunimit ndërinstiucional. Për ata qytetare në pamundësi financiare, të cilët kanë nevojë për tju drejtuar Gjykatës, për përfitimin e ndihmës juridike dytësore ligji parashikon se së bashku me formularët duhen bashkëlidhur disa dokumenta provues, ku një prej tyre është vërtetimi nëse disponojnë automjet ose jo, i cili merret pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor. Gjendur në kushtet ku kjo kategori vunerabel e ka të vështirë marrjen e këtij vërtetimi pasi Drejtoria ndodhet larg qytetit dhe është një shërbimi i cili nuk ofrohet në portalin E-albania, kerkuam bashkepunim per marrjen e ketij vertetimi zyrtarisht nga ana e Qendres pa qenë e nevojshme të paraqiten qytetarët personalisht, duke ju ardhur sa me shpejte ne ndihme kesaj kategorie vunerabel. Në përfundim të takimit drejtuesi i këtij institucioni shprehu gadishmërinë e tij dhe bashkëpunim të mëtejshëm si dhe bëmë të mundur afishimin e posterit pranë sporteleve.





Pjesëmarje në një takim të zhvilluar nga Romacted i implementuar nga Këshilli i Europës në kuadër të "Referimit dhe njohes së antixhipsizmit" në bashkëpunim me KMD dhe Bashkia Roskovec ku ishin të ftuar punonjës social, psikologë, njësia e mbrojtjes së fëmijëve dhe nxënës të shkollave. Gjatë takimit pati diskutime mbi këtë fenomen si dhe ndihma që ofrohet nga shërbimi ligor falas.



Më datë 30.05.2022 Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Fier mori pjesë në një tryezë të përbashkët me aktorë të tjerë institucionalë pranë Bashkisë Roskovec, si anëtarë të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit për parandalimin dhe Mbrojtjen e grave nga dhuna në familje dhe jo vetëm, në kuader të projektit “Forumi i dialogut social përmirëson shërbimet sociale për gratë viktima të dhunës në familje.



Më datë 02 .06.2022 u zhvillua një takim pranë " Shtëpisë së të Moshuarve" Fier, për të trajtuar një rast nga afër pasi nuk kishte mundësi të paraqitej pranë Qendrës dhe në këtë mënyrë përfituesi u paraqit në këtë takim ndërinstytucional.



Praktika e studentëve pranë Qendrë së Shërbimit të Ndihmës Juridike Vlorë




Më datë 13.06.2022 pjesëmarrje në trajnimin e organizuar nga FSHDPAK ADRF për ofruesit e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje dhe atyre me bazë gjinor. Në trajnim u diskutua mbi ndërhyrjet e domosdoshme për një reagim gjithëpërfshirës për gratë me aftësi të kufizuara për t'i bërë shërbimet të arritshme dhe të përdorshme për gra e vajza me aftësi të kufizuara.



Qendra e Ndhmës Juridike Parësore Fier organizoi një takim më datë 22.06.2022, referuar ftesës nga Znj. Albana Gërxi Asistente Ligjore, Departamenti i Ligjit dhe te Drejtave të Njeriut si dhe Z. Cailean Maclean Shefi i Departamenti i Ligjit dhe te Drejtave të Njeriut nga OSCE (Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë). Gjatë këtij takimi/ interviste u diskutua mbi ligjin 111/2017, për ndihmën juridike parësore dhe dytësore. Garantimin e mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve, aksesimi në gjykatë, strukturimi dhe funksionimi i qendrës. Gjithashtu u diskutua mbi hartën e re gjyqësore dhe si ndikon kjo mbi qytetarët që janë përftues të këtij ligji, mbi natyrën e çështjeve më të spikatura, kategorit e vecanta që kanë përfituar më së shumti ndihmë juridike falas si dhe komunitetet përfituese. Në këtë takim u diskutuar edhe nëse kemi një fond shtes/burime financiare për zhvillimin e aktiviteteve ndërgjegjësuere. Në përfundim të takimit u kërkua një statistikë mbi numrin e rasteve të trajtuara dhe kategoritë përfituese.



Më datë 24.06.2022 Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Durrës, në bashkëpunim me përfaqësuesit e Shoqatës së Egjiptianëve në Durrës, si edhe mentoruesen e QNL për Qarkun e Durrësit ndermorën një aktivitet sensibilizues në terren duke informuar qytetarët në lidhje me shërbimin juridik parësor dhe dytësor të ofruar nga ana e Qendrës. Aktivite u organizua kryesisht në zonën e Shkozetit dhe Nishtulla, ku është i përqëndruar komuniteti egjiptian. Qytetarët u informuan mbi shërbimet e ofruara nga ana e Qendrës, u shpërndanë fletëpalosje dhe u afishuan poster. Në këto takime punonjësit e Qendres së Ndhmës Juridike Parësore Durrës njohën edhe me nga afër me problematikat e këtij komuniteti, ku një ndër problematikat kryesore ishte mungesa e strehimit, ose për ata që dispononin strehimin social hasnin probleme të ndryshme në përditshmeri. Gjaë këtij aktiviteti, duke qenë se u zhvillua në terren, u informuan edhe qytetarë të tjerë që gjendeshin në atë zonë.





U zhvillua trajnimi mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti për avokatët ofrues të këtij shërbimi.

Ky trajnim u zhvillua nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë në kuadër të Projektit “Fuqizimi i profesionalizmit të avokatëve në përfaqësimin dhe mbrojtjen e kategorive vulnerabël, përfituese të ndihmës juridike, me qëllim ofrimin e një shërbimi cilësor në proceset civile dhe penale”, mbështetur nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD) si pjesë e projektit “Zgjerimi i shërbimit të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri” EFLAS që zbatohet nga PNUD në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë me mbështetjen financiare të Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim (ADC).

Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, z. Qirici krahas vlerësimit të bashkëpunimit me aktorët kyç të ndihmës juridike falas dhe arritjeve që nga fillimi i funksionimit të sistemit, ndau disa nga problematikat kryesore të evidentuara në praktikë.

Në fund të fjalës së tij, Drejtori i Përgjithshëm shprehu gadishmërinë e plotë të tij dhe stafit të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në angazhimin maksimal në kuadër të forcimit të bashkëpunimit me të gjithë aktorët, Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë, Ministrinë e Drejtësisë me qëllim ofrimin e një shërbimi ligjor sa më cilësor, eficient dhe profesional,



Drejtoria e Ndhimës Jurdike Falas mori pjesë në takimim e zhvilluar nga Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në partneritet me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD) për të ndarë gjetjet dhe rekomandimet e vlerësimit mbi: “Qasjen dhe përdorimin familjar të transfertave të mbrojtjes sociale nga familjet dhe individët në nevojë, viktimat e dhunës në familje dhe personat me aftësi të kufizuara”.

Drejtori i Përgjithshëm z. Qirici u shpreh se do ishte një vlerë e shtuar në raport evidentimi krahas ndihmës ekonomike dhe i ndihmës juridike, duke qenë dy procese të ndërlydhura me njëra tjetrën dhe që ecin paralelisht. Krahas vlerësimit dhe sugjerimeve mbi raportin, ndau me të pranishmit disa të dhëna statistikore sa i përket ofrimit të ndihmës juridike falas për viktimat e dhunës, abuzimit seksual dhe trafikimit



Qendra e Shëbimit të Ndhimës Juridike Parësore në bashkëpunim me përfaqësuesen e Këshillit të Europës për projektin RomActed, zhvilluan një takim me disa përfaqëues të komunitetit Rom të Novoselës të cilët paraqiten disa problematika.



Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në kuadër të bashkëpunimit me organizatën Caritas Shqiptar me të cilën ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, zhvilloi trajnimin me temë: “Forcimi i kapaciteteve të aktorëve që ofrojnë ndihmën juridike parësore dhe dytësore për garantimin e aksesit të barabartë në sistemin e drejtësisë të azil kërkuesve dhe refugjatëve në Shqipëri”.

Ky workshop pat si qëllim garantimin e një shërbimi ligjor efektiv të target grupit që parashikohen në Ligjin 111/2017 “Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti”, konkretisht Neni 10, Pika 1, shkronja ç : Azilkërkuesit, personat që gëzojnë statusin e refugjatit dhe personat që janë në proces ankimi të vendimeve administrative dhe/ose gjyqësore për refuzimin e aplikimit për azil ose revokimin e vendimit të statusit të refugjatit, sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë.

Morën pjesë punonjësit e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, përfaqësues të OJF-ve të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë dhe studentë të angazhuar pranë Klinikave të Ligjit me të cilët DNJF ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.

Në fund pjesëmarrësit u pajisën me çertifikata.





Në kuadër të bashkëpunimit të frytshëm midis Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe Institucioneve të Arsimit të Lartë me të cilët kemi nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, u zhvillua praktika e studentëve pranë institucionit të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas